



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.13, datë 17. 07. 2009

**PËR**  
**“RISHPËRNDARJEN E FONDEVE NË PROGRAMIN E INVESTIMEVE**  
**TË BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANES PËR VITIN 2009”**

Mbështetur në nenin 19, pika 9 dhe nenin 32, “gërma “dh” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenin 44, paragrafi i dytë, gërma “a” të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; udhëzimin nr.2 datë 12.01.2009 për “Zbatimin e buxhetit të vitit 2009” dhe VKB-në nr.1, datë 03.02.2009 për “Miratimin në parim të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2009-2011 dhe miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës, për vitin 2009”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak, sipas relacionit të përgatitur nga Administratori i Përgjithshëm, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve të investimeve nga Nën/Programi i Investimeve të Administratës Vendore në shumën 15,000,000 lekë në Nën/Programin e Investimeve të Kulturës dhe Turizmit në po këtë shumë, sipas Tabelës nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Finance Administrates, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Drejtoria e Prokurimeve Publike.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 (dhjetë) ditë mbas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

**K R Y E T A R**

